

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve U. K. nga fshati komuna e dhe Sh. E nga fshati komuna e për shkak të bashkëkryerjes së veprave penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën.par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzave së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2814/14, dhe 2819/14 dt. 23.01.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur më datën 06.10.2017 në prezencën e prokurorit Zejnullah Gashi, të akuzuarëve U. K. dhe Sh. E më datën 09.10.2017 në mungesë të palëve publikisht mori dhe shpalli këtë

AKTGJYKIM

Të akuzuarit;

U. K., nga i ati S. dhe e ëma Sh. e lindur E., i lindur më datën , në tani banon në fshatin komuna e , i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

Sh. E., nga i ati dhe e ëma B. e lindur K., i lindur më datën , në tani banon në fshatin komuna e , i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

JANË FAJTOR

I. Se më datën 27.09.2014 rreth orës 19:00 në Prizren, në ndertesën e , pikërisht në bifenë “”, në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër marrin pasurinë e lauajtshme të dëmtuarit F. M., në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, kohën e natës, mos prezencën e njerëzve, me forcë duke e dëmtuar dritaren hyjnë brenda në lokal dhe nga aty marrin një aparat të kafesë dhe një mulli për kafe, pastaj ikin nga vendi i ngjarjes.

Kështu që në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën. par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

II. Se më datën 06.10.2014 në orët e mesnatës në Prizren në rrugën “” në lokalin e rrobaqepësisë “”, në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër marrin pasurinë e lauajtshme të dëmtuarit I. K., në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, kohën e natës, mos prezencën e njerëzve, me një kaçavidë me forcë e hapin derën hyrëse të lokalit dhe nga aty marrin një lap-top “P8 Packard Bell” të markës “Easy Note” në vlerë prej 500 euro, si dhe nga kasaforta e lokalit para të imëta në vlerë prej 60 euro dhe ikin nga vendi i ngjarjes.

Kështu që në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën. par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 6, 7,17, 41, 42, 45, 46 dhe 73 të KP-së,

Të akuzuarit Urim Kabashi i'a shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite për veprën penale si nën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite për veprën penale si nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), për veprën penale si nën. I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), për veprën penale si nën. II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Të akuzuarit Sh [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR] i'a shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh për veprën penale si nën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh për veprën penale si nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), për veprën penale si nën. I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), për veprën penale si nën. II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në bazë të nenit 80 të KP -së;

Të akuzuarit U [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] i'a shqipton

DËNIMIN UNIK ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, të cilin dënim do t'a vuaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DËNIMIN UNIK ME GJOBË

Në shumë prej 300 € (treqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë, respektivisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim.

Të akuzuarit Sh [REDACTED] E [REDACTED] i'a shqipton

DËNIMIN UNIK ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, të cilin denim do t'a vuaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DËNIMIN UNIK ME GJOBË

Në shumë prej 300 € (treqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë, respektivisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim.

Palët e dëmtuara F [REDACTED] (S [REDACTED]) M [REDACTED] nga [REDACTED] rr. "[REDACTED]" nr. [REDACTED] dhe L [REDACTED] U [REDACTED] K [REDACTED] nga [REDACTED] rr. "[REDACTED]" nr. [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin civilo-juridik

Obligohen të akuzuarit që t'i paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate, dhe ne emër të paushallit gjyqësor gjithësecili do të paguajnë shumën e të hollave nga 100 €, (gjithsecili) në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë Gjykatë, ka parashtruar aktakuzat PP.nr.2814/14, dt.23.01.2015 dhe 2819/14 të datës 23.01.2015, ndaj të akuzuarve U [REDACTED] K [REDACTED] dhe Sh [REDACTED] E [REDACTED] nën dyshimin se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën.par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar me propozim të prokurorit ka bërë bashkimin e lëndëve P.nr.147/15 dhe 160/15 në një lëndë në bazë të nenit 35 të KPP -së, për shkak të ekonomizimit të procedurës.

Prokurori i Shtetit Zejnullah Gashi në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimare ka deklaruar se: qëndroj në tërësi pranë aktakuzave PP.nr. 2814/14 të dt. 23.01.2015, kundër të akuzuarëve U [REDACTED] K [REDACTED] dhe Sh [REDACTED] E [REDACTED] për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par. 1 nën.par. 1 lidhur me nenin 31 të KP -së, për shkak se gjatë administrimit të provave gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe pas marrjes në pyetje në prokurori, në prezencën e avoketërve të tyre mbrojtës, këtu të akuzuarit i kanë pranuar veprat penale për të cilat ngarkohen, të cilët deklarata janë dhënë me vullnetin e tyre dhe pa presion, andaj duke i marrur parasysh të gjitha këto i propozoj gjyqtarit që të njëjtit t'i shpall fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e denimit, gjykata të marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të akuzuarit. Si rrethanë rënduese të marrë përsëritjen e shumë veprave penale, fenomenin në rritje të veprave penale të vjedhjes në rajonin tonë dhe rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, si rrethanë lehtësuese gjykata të marrë parasysh se gjatë marrjes në pyetje në prokurori të pandehurit kanë pasur një qëndrim jashtëzakonisht korrekt.

I akuzuari U [redacted] K [redacted] në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk e ndiej vetën fajtor dhe kërkoj nga gjykata që mbi bazën e provave të administruara të më liroj nga akuza.

I akuzuari Sh [redacted] E [redacted] në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk e ndiej vetën fajtor dhe kërkoj nga gjykata që mbi bazën e provave të administruara të më liroj nga akuza.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve të dëmtuarit: F [redacted] M [redacted] dhe L [redacted] K [redacted] si dhe janë administruar provat materiale si raportet e oficerit me nr. të rastit 2014 GA [redacted] të datës 28.09.2014, 2014 GA [redacted] të datës 06.10.2014, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dt. 27-28.09.2014, 05-06.10.2014, lista e dëshmimeve të dt. 28.09.2014, raporti i ekzaminimit njesia "[redacted]" në Pizren dt. 17.10.2014 dhe fotoalbumin e dt. 27-28.09.2014, 05-06.10.2014, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike.

I dëmtuari-dëshmitari F [redacted] M [redacted] ka deklaruar se: qëndroj në deklaratën e dhënë në polici dhe shtoj se më është thyer dritarja, e kam gjetë ë thyer, brenda më kanë marrë një aparat që bluan dhe që shërben për kafe dhe mullirin e kafës dhe një paket me kafe, edhe dera e hyrjes së lokalit është thyer dhe gjithë hapësira në lokal ka qenë rrëmujë dhe pas kësaj e kam njoftuar policinë të cilët kanë vazhduar me procedurat tyre.

I dëmtuari - dëshmitari L [redacted] K [redacted] ka deklaruar se: pasi që e kam hapur lokalin në ditën kritike, dera kishte qenë e hapur kish pas tollovi brenda, tek arka, disa të holla të imta që kanë qenë në arkë kanë munguar janë marrur, edhe lap -topi (komjuteri) ka munguar në lokal.

Nga leximi i raporteve të oficerit nr. 2013 GA [redacted] të datës 28.09.2014 dhe 2014 GA [redacted] të datës 06.10.2014, në mënyrë kronologjike përshkruhet ngjarja rreth veprave penale.

Nga leximi në raportin e ekzaminimit Njesia [redacted] në Prizren dt. 27-28.09.2014, si përmbledhje është vërtetuar fakti se gjatë procesimit të gjurmëve të gishtërinjeve janë arritur që të zbulohen disa prekje - gjurmë të gishtërinjeve, të cilat janë evidentuar me nr. dësh. D1, D2, D3 dhe D4 të cilat janë dërguar në sistemin [redacted] për identifikim të dyshuarve të mundshëm.

Nga leximi në raportin e ekzaminimit Njesia [redacted] në Prizren dt. 05-06.10.2014, si përmbledhje është vërtetuar fakti se gjatë procesimit të gjurmëve të gishtërinjeve nuk janë arritur që të zbulohen ndonjë gjurmë e vlefshme e gishtërinjëve.

Nga leximi i raporteve të këqyrjes së vendit të ngjarjes dt.27-28.09.2014, 05.06.2016 nga parashtruesi i raportit është pasqyruar në tërësi vendi, koha e ngjarjes së kryerjes së veprave penale dhe të gjeturat në vendin e ngjarjes.

Nga foto-albumet e bëra në vendin e ngjarjes dt.28.09.2014 dhe dt.05-06.10.2014, vërehet pamja e lokaleve nga jashtë, dhe brenda, dhe dëmet që janë bërë brenda dhe jashtë lokaleve.

I akuzuari U [redacted] K [redacted] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: qëndroj në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe nuk kam tjetër qka të deklaroj.

I akuzuari Sh [redacted] E [redacted] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk qëndroj në deklaratën e dhënë në prokurori dhe nuk kam tjetër qka të deklaroj.

Gjykata pas adminstrimit të provave ka vërtetuar këtë gjendje faktike se të akuzuarit në bashkëveprim:

Më datën 27.09.2014 rreth orës 19:00 në Prizren, në ndërtesën e [REDAKTUAR], pikërisht në bifenë "[REDAKTUAR]", në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër marrin pasurinë e lauajtshme të dëmtuarit F [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR], në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, kohën e natës, mos prezencën e njerëzve, me forcë duke e dëmtuar dritaren hyjnë brenda në lokal dhe nga aty marrin një aparat të kafesë dhe një mulli për kafe, pastaj kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Më datën 06.10.2014 në orët e mesnatës në Prizren në rrugën "[REDAKTUAR]" në lokalin e rrobaqepësisë "[REDAKTUAR]", në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër marrin pasurinë e lauajtshme të dëmtuarit L [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, kohën e natës, mos prezencën e njerëzve, me një kaçavidë me forcë e hapin derën hyrëse të lokalit dhe nga aty marrin një lap-top "P8 Packard Bell" të markës "Easy Note" në vlerë prej 500 euro, sid he nga kasaforta e lokalit para të imëta në vlerë prej 60 euro dhe ikin nga vendi i ngjarjes.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të dhënë në polici më datë 10.11.2014, 11.11.2014 dhe në prokurori më dt. 24.12.2014 ku në prani të avokatëve mbrojtës në mënyrë vullnetare të lirë, pa qenë nën kërcënim, mashtrim apo lajthim, ku në mënyrë detale - kronologjike i kanë përshkruar veprimet e tyre rreth kryerjes së veprave penale dhe e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave dhe kanë deklaruar se e ndiejnë vetën fajtor dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla. Andaj gjykata këtyre deklaratave u'a fali besimin ndërkaq ndryshimin e deklaratave në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura të cilët të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë këtë të akuzuarit e bënë për t'u ikur përgjegjësi penale- juridike dhe gjykata nuk u'a fali besimin.

Andaj nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarëve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre. Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KP-së, si rrethanë lehtësuese e vlerësoj se: janë relativisht të moshës së re, dëmi nuk është i lartë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata e vlerësoj vendin, kohën dhe mënyrën dhe rrethanat se si është kryer vepra penale, vendi ku të akuzuarit kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, vepra është kryer në orët e mbrëmjes, duke shfrytëzuar mungesën e njerëzve, janë recidivist të veprave penale të vjedhjes, edhe pse është konstatuar se ka pasur rrethana tejet rënduese në raport me të akuzuarit, gjykata bëri zbutjen e dënimit nën kufirin ligjor të paraparë për këtë veprë në bazë të nenit 75 të KP -së, pasi që të njëjtit ishin relativisht të rinjë në deklaratën e dhënë në prokurori të njëjtit kanë shprehur keqardhje dhe janë penduar për veprat e kryera dhe i shqiptoi dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimet i shqiptuar janë në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprat penale për të akuzuarit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa udhëzimi i palës se dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil u mbështet ne nenin 463 te KPP-së. Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.147/15, dt.09.10.2017

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimi te këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.